



## KOLEGJI DARDANIA

Rr. "Ibrahim Luliu" Nr.93 10000 Prishtinë  
Tel: +381 (0) 38 247-587 / +377 (0) 44 636-359  
Web: www.kolegjidardania.com



### UDHËZUES

#### **Ky udhëzues shërben për tu njoftuar me procedurat e mbrojtjes virtuale të punimit të diplomës për master gjatë periudhës së pandemisë COVID19**

Në bazë të udhëzimeve të Institutit Kombëtar të shëndetësisë Publike dhe Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë, për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, në mbrojtje të shëndetit të studentëve, personelit akademik dhe jo akademik, familjeve dhe gjithë shoqërisë, në pamundësi të mbajtjes fizike të mësimit, Kolegji Dardania që nga data **26.03.2020**, zyrtarisht ka filluar mësimin virtual.

Nga periudha e marrjes së vendimit, studentëve të studimeve master dhe bachelor të cilët kanë përfunduar provimet sipas rregullores nr. 569/031 në fuqi, do t'u mundësohet paraqitja dhe mbrojtja e punimit të diplomave përmes platformës online/virtuale (skype dhe google meet).

Për t'u realizuar i gjithë ky proces, dekanët e njësive akademike kanë krijuar rrethana lehtësuese administrative duke kryer procedurat e nevojshme administrative në formë elektronike, me kusht që dosja fizike e kandidatëve të plotësohet para pajisjes me diplomë.

#### **Procedurat për mbrojtje të punimit të diplomës master**

Procedurat, që duhen ndjekur për të realizuar mbrojtjen e punimit të diplomës në nivelin master janë nxjerrë, duke u bazuar në dispozitat e Rregullores nr. 569/031 për studimet master shkencor, të adaptuara në përshtatshmëri me rrethanat nën masat e pandemisë COVID-19, për mbrojtje virtuale të punimit të diplomës dhe atë si në vijim:

#### **Punimi i temës së diplomës**

##### **Neni 1**

1. Studenti mund të parashtojë kërkesë për miratimin e propozimit të tezës përkatësisht projekt propozimin e punimit të diplomës master, pasi të ketë përfunduar të gjitha obligimet me planin dhe programin mësimor. Si mentor potencial i studentit është mësimdhënësi në konsultim me të cilin studentin është përcaktuar për temën e punimit të masterit.
2. Forma e kërkesës për miratim të tezave për punim të diplomave master është në formë elektronike për të gjithë studentët e Kolegjit Dardania.



## KOLEGJI DARDANIA

Rr. "Ibrahim Luliu" Nr.93 10000 Prishtinë  
Tel: +381 (0) 38 247-587 / +377 (0) 44 636-359  
Web: www.kolegjidardania.com

3. Kërkesa për miratimin e temës master bëhet me shkrim në adresë të email'it zyrtar të mësimdhënësit, i cili mund të jetë mentor potencial i kandidatit. Projekt- propozimi për temë master duhet të përmbaj elementet si :
  - 3.1 Arsyetimin e temës së propozuar
  - 3.2 Qëllimin e studimit
  - 3.3 Përmbledhja e literaturës së shqyrtuar
  - 3.4 Pyetjen hulumtuese dhe hipotezën/ at,
  - 3.5 Metodologjin e studimit
  - 3.6 Rezultatet e pritura të studimit
  - 3.7 Referencat e literaturës së shqyrtuar
4. Detajet, formati dhe proceset e planifikimit të projekt propozimit elaborohen në "Doracakun e tezës master" i miratuar nga këshilli i Kolegjit si dokument plotësues. Studentët kanë qasje edhe në mënyrë elektronike në këtë dokument.
5. Pas vendimit për lejimin e temës së propozuar nga Kolegjiumi i studimeve master, kandidati përqendrohet në punimin të tijë master, gjithnjë duke u mbështetur nga ana e mentorit me anë të takimeve virtuale.

### Neni 2.

Kandidati/ja, në bashkëpunim me mentorin, mund të paraqesë kërkesë për vlerësim të dorëshkrimit me anë të kërkesës F2, jo më parë se tre muaj pas datës së vendimit (përmes votimit virtual) të Këshillit të Fakultetit për aprovim të kërkesës për vlerësim të projekt propozimit.

### Neni 2

1. Kolegjiumi i studimeve master me propozimin e kandidatit dhe sipas evidences së zyrtarit i cili e udhëheq protokolin e temave të lejuara dhe të mentorëve të cilët i mentorojnë kandidatët, e propozon përbërjenë e komisionit prej tre antarësh për vlerësimin e tezës së masterit.
2. Njëri nga anëtarët e Komisionit është mentor i kandidatit, i cili e udhëheq studentin gjatë realizimit të punimit të masterit .
3. Mentori dhe kandidati në bashkëpunim vendosin kohën optimale të takimeve virtuale për diskutime rreth temës.
4. Nga dy anëtarët të tjerën të Komisionit vlerësues caktohet kryesues i komisionit i cili udhëheq procedurat e mbajtjes së tezës së masterit në platforma virtuale.



## KOLEGJI DARDANIA

Rr. "Ibrahim Lutfiu" Nr.93 10000 Prishtinë  
Tel: +381 (0) 38 247-587 / +377 (0) 44 636-359  
Web: www.kolegjidardania.com

5. Në një takim virtual kandidati njoftohet ngashërbimi i studentëve mastër për mënyrën e dorëzimit të tezës në mënyrë elektronike.
6. Kandidati njoftohet se para se ta posedoj diplomën duhet të sjell punimin edhe në katër kopje fizike në Kolegjin Dardania.

### **Procedurat e Mbrojtjes dhe krijimi i hapësirës së përshtaqme**

#### **Neni 3**

1. Studenti duhet të zgjedhë një hapësirë të dedikuar për punë, e cila nuk është pjesë e hapësirave të zakonshme, që shfrytëzohet për argëtim ose për pushim
2. Në mënyrë që mbrojtja të jetë sa më efektive, hapësira prej ku studentin do të bëjë mbrojtjen e punimit të diplomës duhet të jetë larg zhurmës dhe anëtarëve të tjerë të familjes
3. Mbrojtja e punimit të diplomës master zhvillohet përmes platformës online/virtuale, ku qasje duhet të kenë komisioni në përbërje prej tre anëtarëve, studentin i cili mbron punimin e diplomës, procesmbajtësi dhe personat e tjerë të interesuar, të cilët kanë bërë kërkesë përmes email-it për qasje virtuale te kryetari i komisionit
4. Gjatë mbrojtjes studentin nuk guxon të ndërpritet nga anëtarë të familjes apo pjesëmarrësit e tjerë, të cilët kanë qasje gjatë mbrojtjes virtuale, përveç anëtarëve të Komisionit
5. Pajisjet, që nevojiten për mbrojtje virtuale të punimit të diplomës master janë: një kompjuter ose laptop me kamerë, një maus, dëgjuese (opsionale)
6. Mbrojtja e punimit të diplomës është publike dhe zhvillohet para Komisionit duke respektuar rregulloren dhe para audiencës e cila realizohet në mënyrë virtuale

#### **Neni 4**

1. Kryetari i Komisionit e hapë seancën për mbrojtje virtuale të punimit të masterit, paraqet të dhënat lidhur me procedurat e zhvillimit e deri në nxjerrjen e vendimit.
2. Mentori paraqet të dhënat nga referati i Komisionit për vlerësimin e punimit të tezës masterit
3. Kandidati prezanton punimin jo më gjatë s 30 min, një përmbledhje e shkurtër dhe përmbajtësore.
4. Komisioni i vlerësimit kyqet në klasën virtuale të vlerësimit dhe vendosin për notën vlerësuese të kandidatit.
5. Vendimi i Komisionit shpallet publikisht përmes platformës para auditorit

#### **Neni 5**

1. Deri në ditën e marrjes së diplomës, studentin i lëshohet certifikata e diplomimit e nënshkruar nga Dekani i Fakultetit.
2. Fletëparaqitja online dhe raporti i provimeve të nixjerura nga DMIS, i dërgohen zyrtarit të shërbimit të studentëve.



## KOLEGJI DARDANIA

Rr. "Ibrahim Luliu" Nr.93 10000 Prishtinë  
Tel: +381 (0) 38 247-587 / +377 (0) 44 636-359  
Web: www.kolegjidardania.com

3. Kandidati që e mbron me sukses temën e masterit i lëshohet diploma sipas dispozitave të parapara në programin e akredituar
4. Teza e masterit, e mbrojtur me sukses publikohet në web faqe të Kolegjit Dardania, dhe një kopje fizike dorëzohet në bibliotekën e kolegjit.

### Dispzita kalimtre

#### Neni 6

1. Të gjitha procedurat e sipërshënuara do të vlejnjë vetëm gjatë periudhës së pezullimit të mbajtës së mësimit në objektet e fakulteteve.
2. Nga momenti i shfuqizimit të vendimit të qeverisë për pezullim të mbajtjes së mësimit në objektet e fakulteteve, do të zbatohen rregulloret në dispozicion për studimet e nivelit master.

Rektori

-----  
Prof. Dr. Gjyldane Mulla